


ENERGY

GirlsTech
KEDS ACADEMY

Alpin Doğan:
Sfidat tejkalohen
BASHKË



NJË GRUA
përballë
krizës energjetike



Përmbajtja / Contents

NGJARJE

4-7 Ngjarjet që karakterizuan KEDS dhe KESCO / *Events that categorized KEDS and KESCO*

INTERVISTA

8-13 Sfidat tejkalohen bashkë / *Overcoming challenges, together*

BRENDA KEDS

14-19 24 orët sfiduese / *24 challenging hours*

KEDS ACADEMY

20-23 Drejtorët e shkollave të mesme të Kosovës flasin për bashkëpunimin me KEDS Academy / *Kosovo High School Principals talk about the collaboration with the KEDS Academy*

INVESTIME

24-27 KEDS investoi 26 milionë euro në rrjetin distributiv gjatë vitit 2021 / *KEDS invested over 26 million euros in the electricity network in 2021*

RRETH PUNËS

28-31 Një grua përballë krizës energjetike / *A woman withstanding the energy crisis*

PUNËTORËT TANË

32-33 Punëtorët e dalluar të KEDS dhe KESCO / *Outstanding employees of KEDS and KESCO*

PROJEKTI "WOMEN"

34-39 Gratë e KEDS-it dhe KESCO-s tregojnë sekretin e suksesit/ *Women of KEDS and KESCO reveal the secret of their success*

PIKËPAMJE

40-45 Tri pyetje dhe tri përgjigje nga drejtorët e KEDS-it / *Three questions and answers from KEDS' directors*

PËR KOMUNITETIN

46-47 Vajzat në Teknologji - KEDS vjen me programin Girls TECH / *Girls in Technology - KEDS ready to launch Girls TECH program*

OP-ED

48-51 Konsumatori - Mbreti / *Customer - The King*

INOVACION

52-55 Teknologjia më e re në kompani / *The newest technology in the company*

*Shënim / Note

Shqip / English

NGJARJET QË KARAKTERIZUAN KEDS DHE KESCO



KEDS dhe UP nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

Për të nëntin vit me radhë KEDS dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, që ju hap rrugë studentëve të UP-së për t'u bërë pjesë e programit KEDS Academy. Përmes këtij bashkëpunimi, studentët e fakulteteve të ndryshme të Universitetit të Prishtinës do të mund të bëhen pjesë e KEDS Academy, një prej programeve më të suksesshme për ngritje profesionale në vend.

Fillon KEDS Academy 9

Gjithsej 75 nxënës dhe studentë nga gjenerata e 9-të e KEDS Academy kanë filluar zyrtarisht ndjekjen e ligjëratave në dhjetor të vitit 2021. Ndërsa, në shtator të po të njëjtit vit, pjesëmarrësit e gjeneratës së 8-të të KEDS Academy, kanë filluar praktikën në departamente të ndryshme të kompanisë.



KEDS and UP sign cooperation agreement

For the ninth year in a row, KEDS and the University of Prishtina "Hasan Prishtina" have signed a cooperation agreement, which clears the way for UP students to become part of the KEDS Academy program. Through this cooperation, students of various faculties of the University of Prishtina will be able to become part of KEDS Academy, one of the most successful programs in the country for youth's professional advancement.

KEDS Academy 9 students started with the lectures

A total of 75 pupils and students from the 9th generation of KEDS Academy have officially started attending lectures in December 2021. Meanwhile, in September of the same year, the participants of the 8th generation of KEDS Academy, have started the internship in various departments of the company.

EVENTS THAT CATEGORIZED KEDS AND KESCO



KEDS tatimpaguesi i vitit

Në ceremoninë e organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës më 19 shkurt, KEDS ka pranuar çmimin "Tatimpaguesi i vitit", ku përveç investimeve të vazhdueshme që KEDS bën në rrjet, po kontribuon edhe në pjesën e ekonomisë, duke rritur buxhetin e Republikës së Kosovës përmes taksave.

KEDS vazhdon të përkrahë sportin kosovar

Drejtori i Operimeve në KEDS, Milazim Avdiu, ka pranuar në emër të KEDS, fanellën e Kombëtares së Kosovës dhe mirënjohje nga Presidenti i Federatës të Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, si shenjë falënderimi për mbështetjen e vazhdueshme që kompania ka dhënë për sportin kosovar. KEDS vazhdon të jetë partner i paluhatshëm i FFK-së.

KEDS taxpayer of the year

In the ceremony organized by the Kosovo Chamber of Commerce on February 19, KEDS has received the award "Taxpayer of the Year", where in addition to ongoing investments that KEDS is doing in the network, the company is also contributing to the country's economy by increasing the budget of the Republic of Kosovo through taxes.

KEDS continues to support Kosovar sport

The Director of Operations at KEDS, Milazim Avdiu, on behalf of the company, received the jersey of the Kosovo National Team and a certificate of acknowledgment from the President of the Kosovo Football Federation, Agim Ademi, as a sign of appreciation for the continuous support that the company has given to Kosovar sport. KEDS continues to be a devoted partner of FFK.

Shënohet Muaji i Vetëdijesimit për Kancerin e Gjirit

KEDS ka organizuar fushatën vjetore për vetëdijesimin ndaj kancerit të gjirit me moton "Edukim, ndërgjegjësim, mbështetje," nëpër të gjitha distriktet e KEDS në Kosovë. Në kuadër të aktiviteteve për këtë fushatë, tre specialistë nga Klinika e Radiologjisë në QKUK në Prishtinë, mbajtën ligjëratë vetëdijesuese dhe informative për punonjëset gra të KEDS. Për të folur për përballjen personale me kancer të gjirit, e ftuar ishte edhe themeluesja e Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit "JETA/VITA", znj. Nafije Latifi. Muaji u përmbyll me lëshim me litarë nga objekti i KEDS.

Krijimi i kabineteve të informatikës nëpër shkolla

KEDS vazhdon të mbështesë dhe ndihmojë shkollat fillore në vende të ndryshme të Kosovës, duke krijuar laboratorë të kompjuterëve. Gjatë muajit mars, Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Mihail Grameno" – Aneksi 1, në Fushë-Kosovë, për herë të parë ka krijuar kabinetin e informatikës me anë të donacionit modest të KEDS. Kjo shkollë është pajisur me mjete teknologjike, kompjuterë dhe printerë, pajisje të nevojshme që pritet të ndikojnë në përmirësimin e procesit mësimor. Deri më tani janë dhuruar mbi 160 kompjuterë në shkolla të ndryshme të Kosovës.

KEDS marks Breast Cancer Awareness Month

In all districts of KEDS throughout Kosovo was organized the annual campaign for Breast Cancer Awareness Month with the motto "Education, awareness, support." As part of the activities for this campaign, three specialists from the Radiology Clinic at QKUK in Prishtina, held an awareness and informative lecture for female employees of KEDS. To talk about the personal experience with breast cancer, was also invited the founder of the Kosovo Center for Fighting Breast Cancer "JETA / VITA", Ms. Nafije Latifi. The campaign ended with the activity of rappelling down the KEDS building.

Establishment of computer cabinets in schools

KEDS continues to support and assist primary schools in various parts of Kosovo by establishing computer labs. During March, the Primary and Lower Secondary School "Mihail Grameno" - Annex 1, in Fushë-Kosovë, for the first time is equipped with a computer cabinet through a modest donation of KEDS. The school was also equipped with technological tools, computers and printers, and other necessary equipment that are expected to affect the improvement of their learning process.

Until now, over 160 computers have been donated to various schools in Kosovo.



Vazhdon projekti Art n'trafo

KEDS dhe Qendra për Zhvillimin e Artit - Q'art gjatë muajit mars kanë realizuar projektin Art n'trafo, që këdsj radhe ka mbuluar temën e fuqizimit të gruas. Me punime të ndryshme nga artistë të rinj, kryesisht vajza, trafot janë transformuar në vepra arti, në këto 7 qytete të Kosovës: Ferizaj, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Prizren dhe Prishtinë.

Fushata për kursim të energjisë elektrike


Në shtator të vitit 2021 KEDS dhe KESCO kanë filluar me fushatën për kursimin e energjisë elektrike, të realizuar në bashkëpunim me pyetjet e konsumatorëve, ku janë përgjigjur profesionistët e kursimit në KEDS dhe KESCO. Fushata #krejtbashkë ka vetëdijesuar dhe informuar konsumatorët në detaje se si të kursethet sa më shumë energjia elektrike gjatë përdorimit të pajisjeve shtëpiake. Fushata është përhapur shumë në rrjetet sociale, duke arritur shikueshmëri të madhe dhe ka vazhduar për plot tre muaj.

Ongoing Art n'trafo project

KEDS and Art Development Center - Q'art have finished the next Art n'trafo project during March, where this time the project was focused on women's empowerment theme. With various works by young artists, mainly girls, the electrical transformers have been painted into works of art in 7 cities of Kosovo: Ferizaj, Peja, Gjilan, Gjakova, Mitrovica, Prizren and Pristina.

Energy conservation awareness campaign

In September 2021, KEDS and KESCO started an energy conservation campaign where the saving experts at KEDS and KESCO answered consumers' questions regarding the topic. The #savingtogether campaign has raised awareness and informed consumers in detail on how to save energy maximally in the use of household appliances. The campaign was widely spread on social media, reaching great number of customers and continued for a period of three months.



SFIDAT TEJKALOHEN BASHKË

OVERCOMING CHALLENGES, TOGETHER



Alpin Doğan

Kryeshef Ekzekutiv
Chief Executive Officer

I mësuar që të ballafaqohet me sfida menaxheriale gjatë gjithë karrierës së tij, z. Alpin Dogan u zgjodh Kryeshef Ekzekutiv i KEDS-it në tetor të vitit 2021, kur krejt botën veç sa e kishte kapluar kriza energjetike.

Accustomed to deal with managerial challenges throughout his career, Mr. Alpin Doğan was elected Chief Executive Officer of KEDS in October 2021, when the whole world was facing an energy crisis.

Operimi i kompanisë në kohë krize përveç njohurive teknike të cilat ai i zotëronte, kërkoi edhe menaxhim të detajuar të cilën po ashtu e kishte, përvojë kjo që i shërbeu për t'u përballur me të panjohurën në një kohë kur gjërat u përkeqësuan nga ana financiare, me ngritjen e çmimeve të importit në qiell në berzat ndërkombëtare.

Sot, kur e kthen kokën pas, ndihet i lehtësuar, pasi përkundër vështirësive, ia doli.

Ai në një intervistë për revistën Energy tregon në detaje si u ballafaqua me krizën, pasojat e saj, vizionin e tij për zhvillimin e KEDS-it dhe shumë zhvillime të tjera.

Energy: Z. Dogan, ju erdhët në krye të KEDS-it në kohën e krizës. Çfarë ndjesie ishte ajo?

Alpin Dogan: Natyrisht, koha e krizave është më e vështira për secilin. Nëse veçse je zgjedhur udhëheqës i një sektori jetik për vendin dhe ai sektor po ballafaqohet me sfida të mëdha dhe të panjohura, atëherë është përgjegjësi e madhe. Kriza ishte e importuar nga jashtë dhe asnjë sistem elektroenergjetik i botës nuk dinte si të vepronte, si do të ishte e nesërmja.

The operation of the company in times of crisis in addition to the technical knowledge which he already possessed, required detailed management which he also had, an experience that served him to face the unknown at a time when things were worsening financially were skyrocketing on global energy market.

Today, when he looks back, he feels relieved, because despite the challenges, he managed to succeed. In an interview for Energy magazine, Mr. Doğan describes in details how he managed the crisis, its consequences, his vision for the advancement of KEDS and other ongoing developments in the company.

Energy: Mr. Doğan, you became CEO of KEDS in crisis times. How was this experience like?

Alpin Doğan: *Times of crisis are of course difficult times for everyone. Being elected the leader of a vital sector of a country, in the time when that sector is facing big and unknown challenges, is a huge responsibility.*

The crisis was caused from the outside and no power system in the world knew how to operate, nor did they know what tomorrow would be like.



Sigurisht, në ato rrethana fillimisht duhet të besosh në vetveten dhe në bashkëpunëtorët e tu. Hyra me bindje të plotë dhe përkushtim maksimal se do ta bëj më të mirën. Së bashku e bëmë këtë dhe arritëm deri këtu, jo pa vështirësi. Kanë kaluar 7 muaj, por ndjehem sikur të kishin kaluar 7 vjet.

Energy: Si ia dolët mbanë?

Alpin Dogan: Ia dolëm së bashku, me përgjegjësi të lartë në kryerjen e detyrave tona. Kur nga puna jonë varet edhe ofrimi i shërbimeve të energjisë elektrike, në rrethana të jashtëzakonshme njerëzit e vullnetit të mirë angazhohen me tërë qenien që të ofrohet maksimumi i mundshëm që konsumatorët të afektohen sa më pak. Ia dolëm! Natyrisht, jemi duke e bërë më të mirën që të rimarrim veten nga dëmet që kjo krizë i ka shkaktuar sistemit elektroenergjetik. Këto sfida i kaluam sepse qëndruam së bashku. Ishim së bashku që nga fillimi dhe tani po vazhdojmë punën përpara së bashku.

Energy: Ku është KEDS-i sot?

Alpin Dogan: Padyshim pandemia në njërën anë dhe kriza energjetike globale në anën tjetër e kanë bërë të veten. Pasojat janë aty dhe ne po bëjmë maksimumin që t'i rikuperojmë ato. Pandemia duket që po shkon dalëngadalë, por ka shumë paqartësi në tregun global dhe nuk dihet ende cilat do të jenë çmimet e energjisë elektrike në periudhën e ardhshme. Fatkeqësisht prodhimi vendor është i pamjaftueshëm për të mbuluar kërkesën gjatë dimrit dhe në këto rrethana, rëndohet situata. Çmimet në tregun ndërkombëtar vazhdojnë të jenë 7-8 fish më të larta se ato të zakonshmet.

Por ne kemi vazhduar përpara pa u ndalur. Jemi duke e modernizuar rrjetin dhe avancuar shërbimet për konsumatorë. KEDS ka premtuar që për 15 vite do të bëjë 300 milionë euro investime. Tash kemi hyrë në vitin e 9-të të operimit dhe kemi realizuar afër 209 milionë euro në investime. Që do të thotë se ne po qëndrojmë në vijë me premtimet tona, madje po i përmbushim ato edhe para kohe. Po punohet shumë që për 5 vitet e ardhme të ketë rrjet shumë më stabil dhe të sigurt në të gjitha lokalitetet. Gjatë kësaj kohe, rrjeti i tensionit

Of course, in those circumstances you must first believe in yourself and your colleagues. I started with full determination and maximum commitment that I will do my best. By doing our best together, we got here, but we also had challenges along the way 7 months have passed, but it feels like 7 years.

Energy: How did you move forward?

Alpin Doğan: *We did it together, performing our duties with high responsibility. When electricity services depend on the work we do, in such exceptional circumstances people of goodwill commit with all their being to provide the maximum for consumers to be affected as little as possible. And we did accomplish that. Of course, we are doing our best to recover from the damages that this crisis has caused to the power system. We overcame these challenges because we stayed together. We were together from the beginning and now we are continuing to move forward together.*

Energy: Where is KEDS currently?

Alpin Doğan: *Undoubtedly the pandemic on the one hand and the global energy crisis on the other, have had their impact. The consequences are here and we are doing our best to recover from them. The pandemic seems to be going slowly, but there is a lot of uncertainty in the global markets and it is not yet known what the electricity prices will be in the next months.*

Unfortunately, local generation of electricity is insufficient to cover the demand during the winter and in these circumstances, the situation worsens. Prices in international markets continue to be 7-8 times higher than usual. But, we have moved forward without stopping. We are modernizing the network and improving customer service.

KEDS has promised to make 300 million euros of investments in 15 years and now in the 9th year of our operation we have allocated around 209 million euros in investments. This means that not only we are staying in line with our promises, but we are quite ahead of them.

Also, we are working hard to have a much more stable and secure network in all localities for the



të ulët do të riparohet, përderisa investimet në rrjetin e tensionit të mesëm do të përfundojnë në shumicën e qyteteve të Kosovës.

Energy: Pos krizës energjetike, cila është sfida e radhës, si do të duket KEDS-i i së nesërmes?

Alpin Dogan: Jemi të fokusuar në dy drejtime: Rritja e kualitetit të shërbimeve dhe zvogëlimi i humbjeve. Në sfidën e parë objektiv kryesor kemi rritjen e kapaciteteve përmes shndërrimit të tensionit të mesëm nga 10 në 20kV, pastaj përmirësimin e rrjetit elektrik aty ku është i vjetruar, ndërtimin e linjave të reja dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të linjave që mundësojnë operime sa më të mira.

Sivjet ju mund t'i shihni dhjetëra projekte në implementim e sipër dhe puna po vazhdon me intensitet të shtuar. Tashmë në Prishtinë një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve të tensionit të mesëm janë dyfishuar, pra shndërruar nga 10 në

next 5 years. During this time, the low voltage network will be replaced while investments in the medium voltage network will be completed in most of Kosovo's cities.

Energy: Apart from the energy crisis, what is the next challenge, where will KEDS be tomorrow?

Alpin Doğan: *We are focused in two directions: Increasing the quality of services and reducing losses. The main objective we aim to achieve is the increase of capacities through the conversion of Medium Voltage from 10 to 20 kV, then reparation of the old electrical network, the construction of new lines and the continuous maintenance of the lines that enable us the best operations possible.*

This year you can see that dozens of projects are being implemented and the work is continuing with increasing intensity. A considerable part of

20kV, sipas standardeve evropiane të tensionit, ndërsa kemi objektiv dhe kemi nisur projektet që këtë ta bëjmë edhe në qytetet tjera në mënyrë që t'i eliminojmë të gjitha fytyrat e ngushta. Të njëjtën kohë po punojmë që humbjet të zvogëlohen në periudhën afatmesme në nivel të rajonit. Investimet që po bëjmë ndihmojnë, por duhet edhe qasje proaktive. Natyrisht, humbjet nuk janë fenomen që varen kryekëput nga ne, pasi ato përfshijnë edhe institucione tjera, sidomos sistemin e drejtësisë.

the Medium Voltage capacities have been doubled in Prishtina, so they were converted from 10 to 20 kV, according to European voltage standards, while our objectives are to work with such projects in other cities.

We will not stop until we prevent and fix all the overloads issues.

At the same time we are working to reduce losses in the medium voltage at the regional level. The investments we are doing do help, but we also need a more proactive approach.



Unë para kësaj pozite kam udhëhequr pikërisht Departamentin e Humbjeve të Energjisë dhe një pjesë e imja ka mbetur në atë departament. Andaj edhe synoj që t'i rregullojmë njëherë e mirë problemet me humbjet, para përfundimit të kohës sime këtu. Humbjet e energjisë janë një sukses i

As we know, losses are not a phenomenon that depend entirely on us, as they involve other institutions, especially the justice system. Prior to this position, I headed the Department of Energy Losses and a part of me has remained in that department.

përkthyer në rezultate të mëdha nga KEDS, që ka ndryshuar për të mirë, që nga koha e themelimit të kompanisë në vitin 2013.

Atëherë humbjet ishin 31-32 %, ndërsa tani ato kanë rënë në 18%, pra rezultatet janë të prekshme. Synojmë t'i dërgojmë të paktën në mesatare të vendeve të rajonit dhe nuk do të ndalemi asnjëherë në realizimin e atij misioni. Fokus i rëndësishëm do të jetë edhe në orientimin nga energjia e ripërtëritshme. Ne jemi duke e përgatitur rrjetin për Prodhuesit e Energjisë së Ripërtëritshme dhe do të bëjmë maksimumin t'i krijojmë rrethanat sa më të favorshme dhe të nxisim sa më tepër prodhimin e energjisë së pastër.

Energy: Çka e karakterizon udhëheqjen tuaj?

Alpin Doğan: Një sistem që funksionon duke u bazuar në rregulla e ligje, ku bashkëveprojmë të gjithë, nga secili departament e secila njësi, e ku dëgjohet secili zë dhe secila ide. Ne duhet të bisedojmë hapazi dhe të punojmë për të ndryshuar për të mirë. Unë jam jashtëzakonisht i interesuar që të punoj për ta rritur standardin dhe cilësinë në punë, njëherësh duke i dhënë mundësinë gjithsecilit që e meriton të jetë pjesë e KEDS. Transparenca dhe hapësira e pacenueshme për secilin person që ka kualifikim dhe profesionalizëm.

Bio

Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS-it, z. Alpin Doğan, ka lindur më 15.05.1987, në qytetin e Samsun-it, një vend bregdetar me rreth 1.4 milionë banorë në veri të Turqisë.

Përvoja e tij si inxhinier i rrjetit elektrik filloi në vitin 2009, përderisa z. Doğan përfundoi studimet për inxhinieri elektrike dhe elektronike si bursist i plotë në Universitetin Yakın Doğu të Qipros.

Përveç punës si inxhinier i rrjetit elektrik, ai pati edhe pozita menaxheriale në aeroportin Sabiha Gökçen të Stambollit dhe kompani të shpërndarjes së energjisë elektrike në Bursa të Turqisë.

Ai punon në KEDS që nga qershori i vitit 2014, fillimisht drejtor i Departamentit të Humbjeve të Energjisë, më pas Zyrtar Kryesor i Rrjetit, ndërsa nga tetori i vitit 2021 Kryeshef Ekzekutiv.

So, my aim is to fix the percentage of losses during my time here. Energy losses are already a success transferred into great results by KEDS, the percentage has changed for the better, since the founding of the company in 2013.

At that time the losses were 31-32%, while now they have dropped to 18%, so the results are apparent. We aim to decrease losses to the average of other countries in the region, and we will not stop until we achieve this mission. An important focus will also be orienting ourselves towards renewable energy. We are preparing the network for Renewable Energy Producers and we will do our best to create the most favorable circumstances and to promote the production of clean energy as much as possible.

Energy: What characterizes your leadership?

Alpin Doğan: *A system that works based on rules and laws, where we all interact, from each department and each unit, and where every voice and every idea is heard. We need to talk openly and we work to change for better. I am extremely interested in working to raise the standard and quality of work, while giving the opportunity to everyone who deserves, to be part of KEDS. There is transparency and open approach for every person with qualification and professionalism.*

Bio

Chief Executive Officer of KEDS, Mr. Alpin Doğan was born on May 15, 1987, in the city of Samsun, a seaside country of about 1.4 million people in the northern Turkey.

His experience as an electrical network engineer began in 2009, while Mr. Doğan completed his studies in Electrical and Electronic Engineering with a full scholarship at the Yakın Doğu University in Cyprus.

In addition to working as an electric engineer, he also held managerial positions at Istanbul's Sabiha Gökçen Airport and electricity distribution companies in Bursa, Turkey.

He has been working at KEDS since June 2014, initially as director of the Energy Loss Department, later as a Chief Network Officer and since October 2021 as Chief Executive Officer.

24 ORËT SFIDUESE

Secila ditë është planifikuar të ndahet në tri pjesë: 8 orë punë, 8 gjumë dhe 8 kohë e lirë. Por, për t'u ballafaquar me krizën energjetike që e kaploi edhe Kosovën, kur temperaturat ishin më të ulëtat, gjumi dhe koha e lirë mbetën një luks i së kaluarës për kolegët tanë. Puna për ta u bë primare gjatë 24 orëve.

Por, sfida më e madhe nuk mbetet vetëm të punuarit 24 orë. Kolegët tanë të terrenit pavarësisht kushteve atmosferike, duhet të jenë në dispozicion, të gjejnë vendin e prishjes dhe ta rregullojnë atë në kohën sa më të shkurtër, pa e harruar atë më të rëndësishmen: Presioni i vazhdueshëm që ju vjen nga konsumatorët, me kërkesë të vetme të rikthimit të energjisë elektrike.

Bujar Jupaj, Drejtor i Departamentit të Operimeve, ka rrëfyer për periudhat e vështira që u përballën i gjithë Departamenti i Operimeve. Normalisht, duke lënë në rend të parë sezonin e dimrit, sepse punojnë në kushte ekstreme, me mbingarkesa të shumta në rrjet dhe prishje nga ngarkesat e mëdha.

Ndërkaq, me keqardhje për ekipin që ai drejton,



Bujar Jupaj

Each day is meant to be divided into three parts: 8 hours of work, 8 hours of sleep, and 8 of free time. But, facing the energy crisis that gripped Kosovo when temperatures were the lowest, sleep and leisure remained a luxury of the past for our colleagues. Work became the primary thing to do for them within 24 hours.

But, the biggest challenge was not only 24 hours of working. Our field colleagues, should be available all the time, regardless of weather conditions. They have to locate the place of breakdown and fix it in the shortest time possible, without forgetting the most important thing: The constant pressure coming from consumers and their single request, to restore electricity.

Bujar Jupaj, Director of the System of Operation Department, recalls the difficult periods that this entire department faces. Normally, the winter season is the hardest, since they work in extreme conditions, when multiple network overloads and outages from heavy loads occur. Meanwhile, feeling compassionate for the team he leads, he mentioned the fact that during the end-of-year holidays when everyone celebrates at home, his colleagues are out in the field, working. "I feel deeply sorry for our colleagues when during the end-of-year holidays, everyone celebrates together with their families, but we have to be on charge of our duties and ensure a regular supply of electricity," he says.

However, despite the efforts they make every day, they never give up until the basic principle of this department is met: Regular supply of electricity to customers!

"They are amazing. I am proud of each of them, and I thank them for the tireless work they do with deference, responsibility and pride in serving customers", Jupaj says.
All this tremendous work can not be done without

24 CHALLENGING HOURS

përmendi faktin që gjatë festave të fundvitit kur të gjithë festojnë, kolegët e tij janë jashtë duke punuar.

“Më vjen shumë keq për kolegët tanë kur gjatë festave të fundvitit, të gjithë festonin së bashku me familjet e tyre, neve na duhej të ishim në krye të detyrës që të sigurojmë furnizim të rregullt me energji elektrike”, tha ai.

Gjithsesi, pavarësisht mundit që bëjnë çdo ditë, asnjëherë nuk dorëzohen deri në përmbushjen e parimit bazë të këtij departamenti: Furnizim të rregullt me energji elektrike për konsumatorët!

“Janë të jashtëzakonshëm. Jam krenar me secilin prej tyre, dhe ju jam falënderues për punën e palodhshme të cilën e kryejnë më shumë nder, përgjegjësi e krenari në shërbim të konsumatorëve”, thekson Jupaj.

E gjithë kjo punë e madhe, nuk mund të bëhet edhe pa bashkëpunimin e departamenteve mes vete, siç është edhe Departamenti për Shërbim me Konsumatorë, konkretisht Qendra e Thirrjes, që funksionon gjithashtu 24 orë.

Vetëm vitin që lamë pas zëri që dëgjohet pas telefonatës suaj, ka pranuar mbi 1.75 milionë telefonata. Po kaq herë, në dispozicion për të kuptuar saktë problemin, lokacionin dhe pranimin e të dhënave, pa u lodhur asnjëherë.

Sezoni i dimrit është sfidues për të gjithë, e njëjtë edhe për Qendrën e Thirrjes, sepse vazhdon me operim të vazhdueshëm, me mobilizim shtesë. E gjitha kjo për shkak të kushteve të rënduara atmosferike, e me theks të veçantë erërave.

Drejtoresha e Departamentit për Shërbime me Konsumatorë, Tarifa dhe Çështje Rregullative, Rudina Heroi – Puka, sqaroi sfidën dhe gatishmërinë e plotë të Qendrës së Thirrjes në këto kohëra.



Rudina Heroi - Puka

the cooperation of all the departments with one another, such as the Department of Customer Service, namely the Call Center, which also operates 24 hours.

Only in the last year, the voice behind your call received over 1.75 million calls. Equally such, they are available to accurately understand the problem, get the location and accept data without ever getting tired.

The winter season is challenging for everyone, the same for the Call Center, because it continues with unceasing operation and additional mobilization. This is due to severe weather conditions, with a special emphasis on winds.

The Director of the Department for Customer Services, Tariffs and Regulatory Affairs, Rudina Heroi - Puka, explained to us the challenges and the full availability of the Call Center during such times.



“Periudha më sfiduese është gjatë ditëve kur mbizotërojnë kushte të rënduara atmosferike, me një theks të veçantë erërat, që shkaktojnë avari në rrjet, dhe si rezultat kemi ndërprerje të furnizimit të rregullt me energji elektrike deri në mënjanimin e rrezikut.

Pra, në rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara rritet edhe presioni për Qendrën e Thirrjes, ku njëkohësisht pranojmë numër të lartë të thirrjeve nga konsumatorët”, tha ajo.

Mesazhi nga Rudina Heroi Puka:

“Njerëz të dedikuar për punë dhe mjaft të përgjegjshëm. Jam krenare me secilin prej tyre për mënyrën se si i trajtojnë kërkesat, menaxhojnë sfidat dhe përkushtimin që asnjëherë nuk u shteret. Ne fillimisht bëjmë atë që është e domosdoshme, pastaj ajo çka është e mundshme, e duke vazhduar të bëjmë të mundur atë që në fillim nuk ishte.”

Të gjitha pajisjet teknologjike me të cilat komunikohet jashtë e brenda, që shërbejnë si urë lidhëse mes kompanisë dhe konsumatorëve, padyshim që nuk mund të bëhen pa Departamentin e IT-së, prej të cilëve duhet menaxhim e punë pa qenë primare orari i punës.

"The most challenging period is during the days with severe weather conditions, with a special emphasis on winds, which cause breakdowns in the network, and as a result there are outages in the regular supply of electricity until the hazard is eliminated. So, in cases of unplanned outages, the pressure on the Call Center increases, where at the same time we receive a big number of calls from customers", she says.

Message from Rudina Heroi Puka:

"These people are highly responsible and quite dedicated to their work. I am proud of each of them for the way they handle requests, manage challenges and show a commitment that never runs out. We firstly do what is necessary, then what is possible, and then continue to make possible what was not there in the beginning."

All the technological devices from which is communicated outside and inside, and which serve as a bridge between the company and the customers, obviously can not happen without the IT Department, from which management and work are needed at any time.



Por, me punën e menaxhimin, kërkesa e secilit punonjës në këtë departament është QETËSIA.

Kjo është e vetmja formë që ata të zgjidhin çdo çështje shpejt e lehtë, sepse kur ka ndonjë problem dhe ata duhet të veprojnë nën presion të kohës, ky është një faktor që rrit stresin për ta.

Drejtori i këtij departamenti, Orcun Yildirim, duke folur për sfidat, sukseset dhe përditshmërinë që e kanë si departament, tha se një nga çështjet që është më së vështiri të realizohet është - planifikimi.

“Unë do të thosha planifikimi. KEDS-i është një strukturë që jeton 24/7 dhe nevojat e tij mund të ndryshojnë menjëherë, varësisht nga nevoja”, tha ai. Por i pyetur për të arriturat, ai sqaroi me modesti e përpikëri, në aspektin e implementimit të teknologjisë më të sofistikuar në kompani.

“Do të ishte gabim të flisja për një arritje personale për veten time. Çdo softuer i zhvilluar në kuadër të KEDS-it, çdo përditësim i infrastrukturës, çdo proces i ridizajnuar, çdo kërcënim kibernetik i bllokuar, çdo problem i zgjidhur, është sukses i këtij ekipi.

Si KEDS IT, arritja jonë më e madhe është se kemi implementuar teknologji që do t'ua lehtësojë jetën njerëzve dhe se kemi fuqi të implementojmë të reja. Është gjithashtu krenari për ne që të japim shembull për shumë kompani në Kosovë me punën që bëjmë”, shtoi tutje Yildirim.

But, along with work and management, the prerequisite of every employee in this department is CALM. This is the only way for them to solve any issue quickly and easily, because whenever problems arise and they have to act fast under time pressure, such situations add up to their stress.

The director of this department, Orcun Yildirim, speaking about the challenges, achievements and a typical day of their department, said that one of the issues that is the most difficult to achieve is - planning.

"I would say planning. KEDS is a structure that works 24/7 and its needs can change immediately, depending on the situation", he says. But when asked about the achievements, he modestly and accurately explained the implementation of the most sophisticated technology in the company.

"It would be wrong to talk about a personal achievement. Every software developed within KEDS, every infrastructure update, every redesigned process, every blocked cyber threat, every problem solved, is the success of this team. As KEDS IT, our greatest achievement is that we have implemented technology that will make people's lives easier and that we have the power to implement new ones. It is also a pride for us to set an example for many companies in Kosovo with the work we do ", adds Yildirim.



Orcun Yildirim



I mallëngjyer ai tregon se që nga viti 2015 është pjesë e KEDS, prej ku edhe ka njohur ekipin e tij të përkushtuar ndaj sistemit sikur të ishte fëmija i tyre. Sipas tij, ajo se çfarë i ka lënë përshtypje gjatë viteve që punon në Kosovë, konkretisht në KEDS, është hapi ndaj zhvillimit e ndryshimit, duke i shtuar vlera profesionale secilit diskutim.

Mesazhi i drejtorit Yildirim për departamentin:

“Pos profesionistë, ata janë edhe miq shumë të mirë. Unë i falënderoj për punën e palodhshme, sepse fenomeni që ne e quajmë Sistem, nuk mund të jetë efektiv nëse nuk punojmë në harmoni me njëri-tjetrin. I gjithë zhvillimi i kësaj është burim krenarie për të gjithë ne, sepse sukcesi i njërit nga ne është sukcesi i të gjithëve.”

Një ndërlidhje e jashtëzakonshme e tri departamenteve, normalisht duke mos harruar edhe secilin departament me punonjës tejet të zellshëm e profesionalë, ndikon në përmirësimin dhe avancimin e secilit shërbim, edhe nëse puna 24-orëshe është gjithmonë e nevojshme!

Prandaj, mos harroni...

BASHKË GJITHÇKA ËSHTË E MUNDUR!

Enthusiastically, he says he has been part of KEDS since 2015, from where he has known his team and their dedication to the system as if it were their child. According to him, what has impressed him during his years working in Kosovo, specifically in KEDS, is a leap towards the development of change, adding professional value to each discussion

The message of director Yildirim to his department:

"Apart from being professional, they are also very good friends. I thank them for their tireless work, because the phenomenon we call System, can not be effective if we do not work in harmony with each other. The whole development of it is a source of pride for all of us, because the success of one of us is the success of all of us. "

An extraordinary coordination of three departments, not forgetting each department that has extremely diligent and professional staff, affects the improvement and advancement of each service, even if 24-hour work is always needed!

Therefore, do not forget...

TOGETHER, EVERYTHING IS POSSIBLE!






DREJTORËT E SHKOLLAVE TË MESME TË KOSOVËS FLASIN PËR BASHKËPUNIMIN ME **KEDS ACADEMY**

Për këto 9 vite sa edhe janë bërë që nga themelimi i KEDS Academy, bashkëpunimi me mbi 20 shkolla teknike të mesme nga e gjithë Kosova, ka qenë pjesë kyçe e programit. Nga këto bashkëpunime, mbi 300 nxënës janë pranuar dhe trajnuar në këtë program dhe shumica e tyre edhe janë punësuar në KEDS.

9 years have passed since the establishment of KEDS Academy, and collaboration with over 20 technical high schools around Kosova, has been a key part of the program from the beginning. From these collaborations, over 300 students have been enrolled and trained in the program and most of them have been employed at KEDS.



Lumnije Tahiri

*Shkolla e Mesme Profesionale
Teknike "Mehmet Isai", Gjilan*

Për këtë numër të revistës ENERGY, kemi biseduar me drejtorët e disa nga këto shkolla për të dëgjuar përshtypjet e tyre rreth bashkëpunimit me KEDS Academy, rezultatet dhe komentet që ata i kanë marrë nga nxënësit e tyre, si dhe pse ata i konsiderojnë programet e tilla të nevojshme në avancimin e dijenive praktike të nxënësve.

Shkolla e Mesme Profesionale Teknike "Mehmet Isai", Gjilan

Kjo shkollë bashkëpunon me KEDS Academy për 6 vite, për këtë bashkëpunim flet drejtoresha e shkollës, znj. Lumnije Tahiri.

Sipas drejtoreshës Tahiri, ndërlidhjet e drejtimeve

For this issue of ENERGY magazine, we spoke with the directors of some of these schools where we discussed their impressions about the collaboration with KEDS Academy, the results and comments they have received from their students and why they consider such programs necessary in advancing students' practical knowledge.

"Mehmet Isai" Technical High School, Gjilan

This school collaborates with KEDS Academy for 6 years, about this collaboration talks the director of this school, Ms. Lumnije Tahiri.

According to director Tahiri, the linking of professional high schools with direct work places

KOSOVO HIGH SCHOOL PRINCIPALS TALK ABOUT THE COLLABORATION WITH THE KEDS ACADEMY

të shkollave profesionale me vende konkrete të punës dhe biznese, siç ndodhë në rastin e KEDS Academy, ku instaluesit elektrik e kanë një derë të hapur për t'u punësuar dhe shkathtësuar në profesione përkatëse, janë të domosdoshme për profilet e shkollave teknike.

Për më shumë ajo përmend disa nga përfitimet e vërejtshme që ka sjellë programi të nxënësit e shkollës së saj.

“Për çdo vit ata nxënës të cilët prahen në programin KEDS Academy aftësohen profesionalisht, mandej kur të kemi nevojë për ndonjë riparim të rrymës në shkollë, të njëjtit

